



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR

Nr. 2442/15 Prot.

Shkodër, më 24.07.2026

NJOFTIM

**PËR FILLIMIN E PROCEDURËS PËR KONKURIM NË LINJËN QYTETËSE TË
TRANSPORTIT TË UDHËTARËVE
“BAHÇALLEK-FERMENTIM-BAHÇALLEK”**

Në mbështetje të Ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar; Ligjit nr.8378, datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar; Ligjit nr.8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore”, i ndryshuar; VKM nr.325, datë 19.03.2008 “Për miratimin e rregullave për pranimin në veprimtarinë e operatorit të transportit rrugorë të mallrave dhe të udhëtarëve, si dhe njohjen e dokumentave zyrtarë të caktuar për këto operatorë”, i ndryshuar; Udhëzimit nr.5627, datë 18.11.2016 “Për përcaktimin e kriterëve, rregullave dhe dokumentacionit për lëshimin e licencave dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor të udhëtarëve brenda vendit”, i ndryshuar; VKB nr.44 datë 25.06.2025 “Për miratimin e rrjetit të linjave, stacioneve të qëndrimit dhe të tarifës së biletave të transportit qytetës dhe rrethqytetës të udhëtarëve në Bashkinë Shkodër”, i ndryshuar me VKB nr.54, datë 30.06.2026; VKB nr.55, datë 30.06.2026 “Për subvencionimin e transportit qytetës të udhëtarëve në Bashkinë Shkodër”, njoftojmë se:

Bashkia Shkodër, ka filluar procedurat për pranimin e praktikave, për të gjitha subjektet e interesuara, të cilët kërkojnë të konkurojnë për të fituar të drejtën e ushtrimit të aktivitetit të transportit të udhëtarëve në linjën qytetëse, **Bahçallek-Fermentim-Bahçallek**.

Dorëzimi i dokumentacionit për linjën bëhet pranë Zyrës me një ndalesë nga data 24.07.2026 – 07.08.2026 nga ora 09:00 deri në 16:00.

Dorëzimi i dokumentacionit bëhet pranë Zyrë së protokoll arkivit të Bashkisë Shkodër.

BASHKIA SHKODËR
KRYETAR
Benet Beci



**DOKUMENTACIONI DHE STANDARTET TEKNIKE QË DUHET TË PARAQESIN
SUBJEKTET PËR LINJËN TRANSPORTIT QYTETËS TË UDHËTARËVE
“BAHÇALLEK-FERMENTIM-BAHÇALLEK”**

Baza Ligjore:

Ligj nr.8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore” i ndryshuar,

VKM Nr.325, datë 19.3.2008 “Për miratimin e rregullave për pranimin në veprimtarinë e operatorit të transportit rrugor të mallrave dhe të udhëtarëve, si dhe për njohjen e dokumenteve zyrtare, të caktuara për këta operatorë”, i ndryshuar

Udhëzim nr.5627, datë 18.11.2016 “Për përcaktimin e kriterëve, rregullave dhe dokumentacionit për lëshimin e licencave dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor të udhëtarëve brenda vendit” i ndryshuar

Të gjitha aplikimet pas datës së përcaktuar në njoftim nuk merren në shqyrtim.

1. Kërkesa për aplikim, lidhja 6 (tërhiqet dhe plotësohet te Zyra me Një Ndalesë)
2. Vetëdeklarimi për reputacionin e mirë të përfaqësuesit ligjor të subjektit transportues dhe drejtuesit/drejtuesve të veprimtarisë, lidhjet 7/1 dhe 7/2 (tërhiqet dhe plotësohet te Zyra me Një Ndalesë)
3. Dokumenti nga një institucion bankar ose financiar, që vërteton gjendje të qëndrueshme financiare, i cili mund të jetë:
 - i) një dokument/garanci bankare;
 - ii) një dokument i lëshuar nga shoqëri sigurimi.Këto dokumente duhet të parashikojnë një vlerë në përputhje me shumat e përcaktuara në pikën 1.2, të nenit 4, (140000 lekë për mjetin e parë dhe 70000 lekë për çdo mjet tjetër në përdorim), si dhe duhet të vërtetojnë se banka/shoqëria e sigurimit janë garant për subjektin që kërkon të licencohet. Gjithashtu, do të pranohen dokumente të lëshuara nga çdo bankë, institucion financiar ose institucione të ngarkuara për këtë qëllim në çdo shtet anëtar të BE-së, ku individi ose subjekti i transportit rrugor apo filiali i tij është regjistruar.
4. Certifikata e kompetencës profesionale për drejtuesin e veprimtarisë, i cili mund të jetë ortaku i vetëm ose një prej ortakëve, apo administratori i subjektit ose një person i punësuar me kontratë për një periudhë të paktën 5 vjeçare;
5. Regjistrimi në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB), ku objekti i veprimtarisë duhet të jetë “Për transport udhëtarësh brenda vendit”. Subjekti i transportit të ketë selinë në Shkodër.
6. Subjekti, të ketë agjenci për shërbimin e udhëtarëve brenda vendit, ose kontratë me një agjenci transporti.
7. Vërtetim nga administrata tatimore me nënshkrim elektronik, për shlyerjen e detyrimeve tatimore
8. Vërtetim nga Bashkia Shkodër për shlyerjen e detyrimeve tatimore

9. Vërtetimi i gjendjes gjyqësore (dëshmi penaliteti) për administratorin dhe drejtuesin teknik të shoqërisë;
10. Dokument i lëshuar nga gjykata, i cili të vërtetojë se administratori dhe drejtuesi teknik i shoqërisë nuk janë në proces penal.

Për mjetet

1. Leja e qarkullimit për çdo mjet (njëhuar me origjinalin)
2. Certifikata e kontrollit teknik të mjeteve (njëhuar me origjinalin)
3. Aktivlerësimi në plotësimin e kushteve të komoditetit të mjeteve në transportin e udhëtarëve brenda vendit, lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor (DPSHTRR), (njëhuar me origjinalin)
4. Regjistrimi i mjeteve në QKB.
5. Listë me targat e mjeteve që duhet të përdorë (në formë përshkrimi dhe katalogu fotografik me ambjentet e brendshme dhe të jashtme të mjeteve)

Për drejtuesin e mjetit, dokumentet si më poshtë

1. Leja e drejtimit për drejtuesin e mjetit, me kategoritë përkatëse për mjetin që drejton (njëhuar me origjinalin)
2. Certifikata e aftësisë profesionale (CAP) për drejtuesit e mjeteve, (njëhuar me origjinalin)

Policë sigurimi

- a. Sigurimin e udhëtarëve nga aksidentet në transportin publik, (njëhuar me origjinalin)
- b. Sigurimin e përgjegjësisë së pronarit ose të përdoruesit të mjetit motorik, për dëmet shkaktuar palëve të treta nga përdorimi i këtij mjeti, (njëhuar me origjinalin)

Përparësitë

Përbën përparësi, referenca dhe çdo dokument tjetër që vërteton eksperiencën në transportin e udhëtarëve.

STANDARTET TEKNIKE TË LINJËS QYTETËSE BAHÇALLEK-FERMENTIM-BAHÇALLEK

1. Numri i mjeteve që operatori, duhet të ketë në pronësi ose në huapërdorje, është 5 (pesë).
2. Viti i prodhimit të mjeteve, nuk mund të jetë më shumë se 20 vite, nga aplikimi për certifikim.
3. Mjetet e transportit qytetës të udhëtarëve, duhet të kenë një numër vendesh ulur dhe në këmbë, jo më pak se 80 vende, me jo më pak se 25% vend ulur.
4. Mjetet e transportit qytetës të udhëtarëve, duhet të jenë të pajisura me:
 - a. kondicionim të ajrit
 - b. me sistemet e mbrojtjes nga zjarri, me kutinë e ndihmës së shpejtë, me dritare emergjence funksionale
 - c. dyert e shërbimit të jenë me hapje të komanduar nga shoferi në mënyrë automatike
 - d. pedanë për personat me aftësi të kufizuar (PAK) dhe hapësirë të dedikuar për karrocë ivalidi ose fëmijësh
 - e. kamera sigurie
5. Mjetet e transportit qytetës të udhëtarëve, të kenë të instaluar sistemin e njohjes së vendodhjes së mjetit (GPS), sipas standarteve bashkëkohore të vendosura nga subjekte të licencuara, duke gjeneruar raportin ditor dhe mujor të kilometrave të kryera nga çdo mjet, targën e tyre dhe emrin e linjës, si dhe akses monitorimi në kohë reale dhe periodike, nga Sektori i Transportit dhe Licencimit.
6. Orari i shërbimit, do të jetë nga ora 06:00 deri në ora 22:00. Frekuenca e lëvizjes, datë jetë: **a.** çdo 20 min nga ora 06:00 deri në ora 14:30, **b.** çdo 30 min nga ora 14:30 deri në ora 21:30 dhe **c.** çdo 30 min nga ora 06:00 deri në ora 21:30, të shtunë dhe të dielë. Stacioni i nisjes së shërbimit do të jetë në “Bahçallek” në ora 06:00. Orari i fundit, do të jetë në stacionin “Fermentim” në 21:30 për të përfunduar në 22:00 në Bahçallek.
7. Operatori i shërbimit, duhet të realizojë me mjetet e certifikuara, deri në 14,939.3 km në muaj. Për përfitimin e subvencionimit, operatori duhet të realizojë jo më pak se 90% të km të planifikuara.